



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 27.08.2019, shpallë :

K O N K U R S PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

I. PUNËTOR TEKNIK

Drejtoria: Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenjes sociale

Qendra për punë sociale

Paga mujore(bruto)- 280.00 €

Numri i referencës së vendit të punës:03-111/01-27356/19

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e objektit të Qendrës për punë sociale
2. Kujdeset për pasurinë e institucionit brenda dhe jashtë objektit
3. Kujdeset për mjetet e punës dhe materialin shpenzues për mirëmbajtjen e higjienës
4. Harton listën e nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës së objektit
5. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i tij.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Shkollimi i mesëm
- përvojë pune (e dëshirueshme)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”-MSHV

Kohëzgjatja e emërimit : Gjashtë (6) muaj

Data e mbylljes së konkursit; mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit, prej **27.08.2019** deri më **02.09.2019**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhës dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomen e shkollës së kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

